

**Burimi:** deklaratat H.B, FDH-16491.

---

## **Sinan (Halil) Gashi**

(13.03.1970, shqiptar nga Çupeva/Čupevo, komuna e Klinës/Klina, punëtor ndërtimor, tre fëmije, pjesëtar i UÇK-së)

Sinani aderoi në UÇK në fillim të 1998. Familjarët e panë të gjallë herën e fundit më 2.05.1998 në Sverkë/Svrhe [Klinë/Klina], ku ai i vizitoi përderisa ata gjendeshin në këtë fshat si refugjatë. Sinani ka gjetur vdekjen në **Panorc/Ponorac** më **4.09.1998**. E kishin qëlluar me një plumb snajperi. Një ditë më vonë, forcat serbe u urdhëruan disa banorëve që ta varrosnin Sinanin me fytyrë të kthyer nga toka, në një arë në afërsi të varrezave të fshatit. Pas lufte, më 1.10.1999, familjarët i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Sinanit. I varrosën ato një ditë më vonë në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Grabanicë/Grabanica [Klinë/Klina].

**Burimet:** deklaratat F.G, FDH-33476; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

---

## **Brahim (Himë) Zulfaj**

(11.03.1924, shqiptar nga Seniku/Senik, komuna e Malishevës/Mališevo, bujk, gjashtë fëmijë)

Familjarët e Brahimit e braktisën Senikun/Senik, kur forcat serbe u stacionuan në afërsi të fshatit. Ai ndenji në shtëpi. Në datën **5.09.1998**, i biri Milazimi, i cili ishte pjesëtar i UÇK-së, së bashku me mikun Halil Bytyqin, shkoi në shtëpi që ta bindte të atin të nisëj me ta. Brahimi u tha që ata të niseshin, ndërkaq premtoi se ai do të nisëj pas tyre, por pak më vonë. Ishte kjo hera e fundit kur ata e panë të gjallë. Në mbrëmje, rreth orës 20:00, bariu nga Seniku/Senik, Osman Kafexhollli, i bëri të ditur Milazimit se forcat serbe e kishin vrarë Brahimin. Në të njëjtën mbrëmje, Milazimi dhe Halili e kanë varrosur Brahimin në livadh [Senik], ku ai kishte gjetur vdekjen. Pas lufte, më 12.10.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Brahimit në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Senik.

**Burimet:** deklaratat J.H, FDH-33622; deklaratat J.H, FDH-3562; deklaratat X.Z, FDH-15160;

deklaratat S.Z, FDH-3561; deklaratat J.Z, FDH-3568; deklaratat J.Z, FDH-3567; fotografi, FDH-36493.

---

## **Sadik (Osman) Morina**

(1929, shqiptar nga Astrazupi/Ostrozub, komuna e Malishevës/Mališevo, bujk, gjashtë fëmijë)

Në muajin korrik të vitit 1998, në shtëpinë e Sadikut gjendeshin afro 60 refugjatë nga fshatrat fqinje. Që të gjithë u larguan më 27.07.1998, kur forcat serbe e nisën bombardimin e fshatit. Shkuan në fshatin Panorc/Ponorac. Në datën, **7.09.1998**, Sadiku me kushëririn Ahmetin u nisën për në **Astrazup/Ostrozup**, për t'i vizituar shtëpitë e veta. Para se të ndaheshin, u morën vesh që mos të vonoheshin shumë dhe, më pas, të takoheshin te vendi i quajtur *Kroi i Canit/Caniev izvor*. Ashtu si u morën vesh, Ahmeti u nis drejtë *Kroit të Canit/Caniev izvor*, por kur vuri re se forcat serbe gjendeshin pranë këtij vendi, ai iku. Dy javë më vonë, më 20.09.1998, vendasi Vesel Morina e ka gjetur trupin e Sadikut te *Kroi i Canit/Caniev izvor*. Ishte i ekzekutuar me një plumb në kokë. Po atë ditë, vëllai i Sadikut, Ganiu, Ahmeti dhe vëllai i këtij të fundit, Fejza, si dhe Vesel Morina, e bartën trupin e Sadikut në Joviq/Jović. Atje e varrosën në një livadh. Pas lufte, më 18.10.1999, mbetjet mortore të Sadikut u varrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Dragobil/Dragobilje.

**Burimet:** deklaratat A.M FDH-15642; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 122, FDH-23857.

---

## **Mihrije (Mahmut) Vrenezi**

(15.06.1919, shqiptare nga Maralia/Maralija, komuna e Malishevës/Mališevo, amvise, katër fëmijë)

Mihrija jetonte te i biri Azizi dhe familja e tij. Shtëpia e tyre ishte në mëhallën, e cila ishte e ndarë nga lagjet e tjera të **Maralisë/Maralija**. Në muajin shtator të vitit 1998, forcat serbe ishin të përqendruara në fshatin Dragobil/Dragobilje. Në pasditen e datës **9.09.1998**, ato e filluan bombardimin e Maralisë/Maralija. Rreth orës 22:00, një prdhë ka rënë pranë shtëpisë së Azizit.